



Dëshironi të njoftoheni për lajmet më të rëndësishme të ditës nga Rtklive?

JO

PO



13:13 / 04.01.2021



PËR 24 ORË, ARRESTOHEN 10 PERSONA PËR ARMËMBAJTJE PA LEJE NGA POLICIA

Në tetë raste të ndryshme, Policia e Kosovës gjatë 24 orëve të fundit ka arrestuar dhjetë persona për armëmbajtje pa leje dhe posedim të paautorizuar të armëve nëpër vende të ndryshme të Kosovës.

Kështu ka njoftuar Policia e Kosovës përmes raportit 24 orësh, ku po ashtu është bërë e ditur se disa nga të arrestuarit janë ndaluar në mbajtje, ndërkaq shumica prej tyre me urdhër të prokurorit janë liruar në procedurë të rregullt.

Detaje nga raporti i Policisë së Kosovës:

Aeroporti i Prishtinës Adem Jashari 03.01.2021 – 09:00. Gjatë kontrollit tek valixhet në nisje te Aeroportit, pronë e të dyshuarit mashkull kosovar është gjetur dhe konfiskuar një elektroskok. Në konsultim me prokurorin kujdestar i dyshuari është liruar dhe rasti procedohet në procedurë të rregullt.

Fsh. Batllavë, Podujevë 03.01.2021 – 16:02. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që në një aheng kishte shtënë me armë zjarri. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar 15 gëzhoja të kal. 9 mm. Nga i dyshuari njëherit pronar i shtëpisë është konfiskuar arma me gas. Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori i shtetit i cili rekomandon që pas intervistimit i dyshuari të lirohet në procedurë të rregullt.

Rr. Agim Ramadani, Prishtinë 03.01.2021 – 09:00. Gjatë kontrollit tek dy te dyshuarit meshkuj kosovar janë gjetur dhe konfiskuar një revole dhe një thikë. Në konsultim me prokurorin e shtetit të dyshuarit pas intervistimit janë liruar dhe rasti procedohet në procedurë të rregullt.

Rr. Idriz Seferi, Gjilan 03.01.2021 – 18:00. Janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj kosovarë, pasi që pasi janë ndalur me veturën e tyre me targa vendore i kanë kundërshtuar zyrtarët policor me çrast njëri nga të dyshuarit dhe një zyrtar policor pësojnë lëndime për çka edhe marrin tretman mjekësor në spitalin e Gjilanit dhe më pas lirohen. Me urdhër të gjyqtarit janë bastisur shtëpitë e të dyshuarve ku janë gjetur dhe sekuestruar: 2.7 gram substancë narkotike e llojit marihuanë, 0.7 gram substancë narkotike e llojit kokainë, 402 (katër qind e dy) €, një pistoletë me gas, një karikator me katër fishek me gas, një peshore digjitale, katër qese te plasmanit me fotolla të telefonit dhe një kofë plastike me fotolla të telefonit. Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori i shtetit me urdhër të së cilit të dyshuarit dërgohen në mbajtje për 48 orë. Rasti vazhdon të hetohet.


Shtime 03.01.2021 – 15:00. Është raportuar një rast dhune në familje dhe gjatë intervistimit i dyshuari mashkull kosovar ka pohuar se e posedon një armë revole në shtëpi. Njësiiti policor së bashku me te dyshuarin kanë shkuar në shtëpinë e të dyshuarit dhe kanë konfiskuar revolen me një karikator me 8 (tetë) fishek kal. 7.62 mm.

Rr. Lloqan-Hulaj 03.01.2021 – 14:50. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që gjatë kontrollit te i dyshuari është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë me një karikator dhe 15 fishek. Pas intervistimit me urdhër të prokurorit kujdestar, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

Fsh. Bellacërkë, Rahovec 03.01.2021 – 11:00. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që gjatë kontrollit te i dyshuari është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë e llojit të panjohur (armë e dëmtuar) me një karikator. Pas intervistimit me urdhër të prokurorit kujdestar, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.


Fsh. Studime e Ultë, Vushtrri 03.01.2021 – 15:00-15:45. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që në një aheng kishte shtënë me armë zjarri. Në vendin e ngjarjes janë gjetur 13 gëzhoja të kal.9 mm. I dyshuari njëherit pronar i shtëpisë ka deklaruar se në shenjë gëzimi për martesën e djalit te tyre kishte shtënë me armë në ajër. Nga i dyshuari është konfiskuar arma me gas. Pas intervistimit me urdhër të prokurorit kujdestar, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt. /Telegrafi/

I MË SHUME NGA KRONIKË E ZEZË




I riu plagoset me thikë pas një përleshjeje në Prishtinë

Postuar 21:56 / 04.01.2021




Aksident në Dollc të Klinës, lëndohen shtatë persona

Postuar 15:18 / 04.01.2021




Babai rrah djalin pasi e akuzon për vjedhje

Postuar 14:25 / 04.01.2021




Mashttrim për viza pune në Gjerman, arrestohet një person në Deçan

Postuar 13:52 / 04.01.2021




Pesë të lënduar në aksidentin në Gjakovë

Postuar 13:29 / 04.01.2021




Gjashtë të arrestuar për dhunë në familje për 24 orë në Kosovë

Postuar 13:10 / 04.01.2021




Kaçanik: Të moshuares i grabiten 55 mijë euro para të gatshme

Postuar 18:10 / 03.01.2021




Arrestohen 16 persona

Postuar 11:18 / 03.01.2021




79 aksidente në trafik për një ditë në Kosovë

Postuar 10:40 / 03.01.2021




Kaçanik, hajnat lidhin gruan dhe nën kërcënimin armës ia vjedhin kasafortën

Postuar 10:02 / 03.01.2021




Arrestohet i dyshuari që plagosi tre persona në Pejë

Postuar 08:13 / 03.01.2021




Të shtëna me armë në Pejë, tre të plagosur – dy në gjendje të rëndë

Postuar 22:52 / 02.01.2021




Rrahet rëndë një sirian në Mitrovicë, bëhet për spital

Postuar 20:14 / 02.01.2021




Mosmarrëveshje në trafik, 6 të arrestuar

Postuar 15:13 / 02.01.2021



Theret me thikë një i mitur në Prizren

Postuar 14:29 / 02.01.2021



Plagoset edhe një femër natën e Vitit të Ri në Viti

Postuar 14:19 / 02.01.2021